



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 347 Prot.

Tiranë, më datë 22.06.2023

VENDIM
Nr. 347, datë 22.06.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 22.06.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes lidhur me kërkesën e UNOPS për shtyrjen e afatit të punimeve për projektin “Restaurimi i Teatrit Kombëtar të Kukullave”, Monument Kategoria I-rë, me projektues “Atelier 4” sh.p.k, me aplikues Endrita Mulleti dhe zhvillues Zyrat e Unops-it në **Shqipëri** me rekomandimin:
 - a) Të përcaktohet në mënyrë të detajuar në grafik emërtimi i punimeve dhe të rishikohet kohëzgjatja e tyre duke iu përmbajtur afateve ligjore;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

